



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,  
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 1 dhjetor 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimit:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënien e Dëshmisë nga W01140  
nëpërmjet Videokonferencës**

---

**Prokurores së Specializuar**

Kimberli P. Uest

**Mbrojtjes së Hashim Thaçit**

Gregori Kihou

**Mbrojtjes së Kadri Veselit**

Ben Emerson

**Mbrojtësit të Viktimave**

Sajmon Loz

**Mbrojtjes së Rexhep Selimit**

Xhefri Roberts

**Mbrojtjes së Jakup Krasniqit**

Venkatesvari Alagenda

**TRUPI GJYKUES II** ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21(2), (4)(f), 23(1) dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 141(1) dhe 144 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 20 nëntor 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi kërkesë ("Kërkesa")<sup>1</sup> me anë të së cilës i kërkoi Trupit Gjykues autorizim për marrjen e dëshmisë së W01140-s nëpërmjet lidhjes me videokonferencë nga një vend i përshtatshëm në shtetin ku banon.<sup>2</sup> ZPS-ja argumenton se Trupi Gjykues duhet ta miratojë Kërkesën pasi është e nevojshme dhe nuk dëmton në mënyrë të papërligjur të akuzuarin.<sup>3</sup>
2. Më 29 nëntor 2023, në bazë të urdhrit të Trupit Gjykues për parashtrime të përshpejtuara,<sup>4</sup> Zyra Administrative dorëzoi vlerësimin paraprak ("Vlerësimi i Zyrës Administrative")<sup>5</sup> ku u shpreh se është e realizueshme dhënia e dëshmisë së W01140-s nëpërmjet videolidhjes.<sup>6</sup>
3. Mbrojtja nuk u përgjigj.

---

<sup>1</sup> F01942, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Dhënien e Dëshmisë nga W01140 nëpërmjet Videokonferencës*, 20 nëntor 2023, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua po atë ditë, F01942/RED).

<sup>2</sup> Kërkesa, para. 1.

<sup>3</sup> Kërkesa, para. 2.

<sup>4</sup> CRSPD370, Mesazh Elektronik i Trupit Gjykues II drejtuar Palëve dhe Pjesëmarrësve në lidhje me Përgjigje të Përshpejtuara ndaj Parashtrimit F01942, 21 nëntor 2023.

<sup>5</sup> F01969, Zyra Administrative, *Vlerësim i Zyrës Administrative në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Dhënien e Dëshmisë nga W01140 nëpërmjet Videokonferencës*, 29 nëntor 2023, konfidencial dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial, F01969/CONF/RED dhe versioni i redaktuar publik, F01969/PUB/RED, u dorëzuan po atë ditë).

<sup>6</sup> Vlerësimi i Zyrës Administrative, para. 9.

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Rregulla 141(1) parashikon se, në parim, dëshmitarët e japin dëshminë e tyre duke qenë të pranishëm në gjyq. Trupi Gjykses mund gjithashtu të lejojë dhënien e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës sipas rregullës 144 dhe në një mënyrë që nuk shkakton padrejtësi, apo që nuk është mospërputhëse me të drejtat e të akuzuarit. Sipas rregullës 144(1) dhe (3), Trupi Gjykses mund të urdhërojë që dëshmia të jepet me videokonferencë, me kusht që nëpërmjet kësaj mënyre dëshmitari të pyetet si duhet. Trupi Gjykses garanton që videokonferenca t'u mundësojë palëve dhe Trupit Gjykses t'i bëjnë pyetje dëshmitarit gjatë dhënies së dëshmisë.

## III. DISKUTIM

5. Trupi Gjykses rikujton se, edhe pse dhënia e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës nuk duhet të merret parasysh vetëm në raste të jashtëzakonshme, prania e dëshmitarit në sallën e gjyqit mbetet opsioni i preferuar.<sup>7</sup> Trupi Gjykses thekson se, kur bën vlerësimin nëse do ta lejojë dhënien e dëshmisë nëpërmjet videolidhjes, Trupi Gjykses mund të shqyrtojë një sërë faktorësh, si “vendndodhja, situata personale dhe gjendja shëndetësore, disponueshmëria dhe siguria e dëshmitarit, si dhe kompleksiteti dhe kohëzgjatja e masave logjistike të udhëtimit dhe përgatitje të tjera që duhen bërë”.<sup>8</sup>

---

<sup>7</sup> F01558, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dëshmi përmes Videokonferencës dhe për Masë të Posaçme për W04337-ën*, 26 maj 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 16 (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 30 maj 2023, F01588/CONFRED); F01776, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënien e Dëshmisë nga W03827 nëpërmjet Videokonferencës*, 8 shtator 2023, konfidencial, para. 12; F01910, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënien e Dëshmisë nga W01493 nëpërmjet Videokonferencës*, 8 nëntor 2023, konfidencial, para. 12; KSC-BC-2020-07, *Transkripti i seancës*, 14 janar 2022, f. 3034, rreshtat 2-5. *Shih gjithashtu ICTY, Prosecutor v. Tadić*, IT-94-1-T, Trial Chamber II, [Decision on the Defence Motions to Summon and Protect Defence Witnesses, and on the Giving of Evidence by Video-Link](#), 25 June 1996, para. 19.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-07, *Transkripti i seancës*, 14 janar 2022, f. 3034, rreshtat 6-10. *Shih për ngjashmëri KSC-BC-2020-04, F00482/RED, Trupi Gjykses I, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e*

6. Gjatë shqyrtimit për miratimin e Kërkesës, Trupi Gjykses vëren se W01140: (i) vuan nga probleme të rënda shëndetësore të cilat përkeqësohen nga udhëtimi;<sup>9</sup> dhe (ii) ka probleme të përhershme që kufizojnë lëvizshmërinë e tij dhe ka pasur nevojë për disa ndërhyrje mjekësore dhe monitorim të vazhdueshëm.<sup>10</sup> Së fundi, Trupi Gjykses vëren se gjendja shëndetësore e dëshmitarit mund të përkeqësohet në mënyrë të papritur, dhe për këtë arsye është e rëndësishme që ai të jetë pranë mjekëve që e trajtojnë.<sup>11</sup>

7. Pasi e shqyrtoi me kujdes Kërkesën, Trupi Gjykses është bindur se ZPS-ja ka vërtetuar se problemet shëndetësore të dëshmitarit, siç paraqiten në Kërkesë, e bëjnë të domosdoshme që W01140 të dëshmojë nëpërmjet videolidhjes. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se, në përgjithësi, mungesa e dëshirës së një dëshmitari për të udhëtuar për në Hagë për të dëshmuar personalisht, nuk është arsye e mjaftueshme për miratimin e një kërkesë për dhënie të dëshmisë nëpërmjet videokonferencës. Është përgjegjësi e palës thirrëse të garantojë që dëshmitari të paraqitet në sallën e gjyqit në Hagë për të dhënë dëshminë.<sup>12</sup> Megjithatë, në rastin konkret, informacioni që ka dhënë ZPS-ja përmban hollësi të mjaftueshme për t'i mundësuar Trupit Gjykses të dalë në përfundimin se lejimi i W01140-s që ta japë dëshminë nëpërmjet videolidhjes nga një vend i përshtatshëm në shtetin ku banon do t'i shërbente më shumë mirëqenies së W01140-s se sa transferimi i tij në Hagë për të dëshmuar personalisht.

8. Për më tepër, Trupi Gjykses mban parasysh vlerësimin paraprak të Zyrës Administrative se është e realizueshme dhënia e dëshmisë së W01140-s nëpërmjet videolidhjes<sup>13</sup> dhe se përdorimi i mjediseve të vëna në dispozicion nga një

---

*Prokurorit të Specializuar për Dhënien e Dëshmime nga TW4-04, TW4-10 dhe TW4-11 nëpërmjet Videokonferencës, 13 prill 2023, para. 13-14.*

<sup>9</sup> Kërkesa, para. 6-7.

<sup>10</sup> Kërkesa, para. 6.

<sup>11</sup> Kërkesa, para. 8.

<sup>12</sup> F01910, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Dhënien e Dëshmisë nga W01493 nëpërmjet Videokonferencës*, 8 nëntor 2023, konfidencial, para. 14.

<sup>13</sup> Vlerësimi i Zyrës Administrative, para. 8, 16.

organizatë ndërkombëtare në vendin përkatës do të mundësojnë përgatitjet e nevojshme logjistike, teknike dhe të sigurisë.<sup>14</sup> Trupi Gjykses vëren se Zyra Administrative do të kryejë një vlerësim përfundimtar pas vendimit të Trupit Gjykses. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses e nxit Zyrën Administrative të veprojë me shpejtësi për të garantuar që masat e nevojshme<sup>15</sup> të zbatohen pa vonesë, për ta bërë vendin e propozuar të përshtatshëm për dëshmi me videokonferencë, dhe ta njoftojë Trupin Gjykses sapo të kenë përfunduar të gjitha përgatitjet e nevojshme për këtë videokonferencë.

9. Trupi Gjykses nuk vlerëson se dëgjimi i dëshmisë së W01140-s me videolidhje e dëmton Mbrojtjen. Trupi Gjykses, të akuzuarit, palët dhe pjesëmarrësit do të jenë në gjendje ta shohin dhe dëgjojnë dëshminë e dëshmitarit në kohë reale dhe do të kenë mundësinë t'i bëjnë pyetje dëshmitarit.

10. Për këto arsye, Trupi Gjykses e vlerëson të përshtatshme ta dëgjojë dëshminë e W01140-s nëpërmjet videolidhjes.

#### IV. VENDIM

11. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **AUTORIZON** W01140-ën të dëshmojë nëpërmjet videokonferencës; dhe
- c) **URDHËRON** Zyrën Administrative të bëjë përgatitjet e nevojshme për dhënien e dëshmisë nga W01140 nëpërmjet videokonferencës dhe t'i informojë Trupin Gjykses, palët dhe pjesëmarrësit, në përputhje me paragrafin 8 të këtij vendimi.

---

<sup>14</sup> Kërkesa, para. 4; Vlerësimi i Zyrës Administrative, para. 14.

<sup>15</sup> Vlerësimi i Zyrës Administrative, para. 11.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Çarls L. Smith, III**

**Kryegjykatës**

E premte, 1 dhjetor 2023

Në Hagë, Holandë.